

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar

P5

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 23.10.2021

1. Në vijim janë draft pasqyrat e pozitës financiare të Clinton, Clark dhe Solana me 31 dhjetor 2020:

	Clinton sh.a €'000	Clark sh.a €'000	Solana sh.a €'000
Pasuritë			
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>			
Prona, fabrika dhe paisjet	1,100	1,000	400
Investimet	<u>180</u>	<u>60</u>	<u>40</u>
	1,280	1,060	440
Pasuritë qarkulluese	<u>500</u>	<u>220</u>	<u>60</u>
Total pasuritë	1,780	1,280	500
Ekuiteti dhe detyrimet			
Ekuiteti:			
Aksionet e zakonshme prej €1 secila	400	100	300
Premia e aksioneve	300	100	-
Fitimet e mbajtura	<u>500</u>	<u>(190)</u>	<u>100</u>
Total ekuiteti	1,200	10	400
Detyrimet:			
Detyrimet afatgjata	300	900	-
Detyrimet afatshkurtëra	<u>280</u>	<u>370</u>	<u>100</u>
Total detyrimet	<u>580</u>	<u>1,270</u>	<u>100</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	1,780	1,280	500

Informatat në vijim janë të rëndësishme:

- (i) Clinton sh.a bleu 90% të aksioneve të zakonshme të Clark sh.a-së me 1 janar 2019 për një konsideratë prej €500,000 e pagueshme me 31 dhjetor 2021. Premia e aksioneve dhe fitimet e mbajtura në atë datë ishin €100,000 dhe €100,000. Ky investim nuk është regjistruar ende në pasqyrat financiare Clinton sh.a.

Vlerat e drejta të pasurive neto në datën e blerjes ishin të barabarta me vlerat e tyre bartëse përveç një zëri të fabrikës. Vlera e drejtë e fabrikës ishte më e lartë se vlera e saj bartëse për €100,000. Kishte një jetë ekonomike të përdorimit të mbetur prej 4 viteve në datën e blerjes. Korigjimet e vlerës së drejtë nuk janë inkorporuar në pasqyrat financiare më sipër.

- (ii) Clinton sh.a bleu 30% të aksioneve të zakonshme të Solana sh.a's me 31 dhjetor 2019 për një konsideratë prej €100,000. Fitimet e mbajtura në atë datë ishin €50,000. Vlerat e drejta të pasurive neto në datën e blerjes ishin të barabarta me vlerat e tyre bartëse. Investimi në Solana sh.a është paraqitur në pasqyrën e pozitës financiare të Clinton sh.a-së sipas koston.

- (iii) Clinton sh.a ka një kosto të kapitalit prej 8%. Faktorët e skontimit janë si më poshtë:

Viti	Faktori i skontimit 8%
1	0.926
2	0.857
3	0.794

- (iv) Gjatë vitit deri me 31 dhjetor 2020, Clark sh.a shiti mallra tek Clinton sh.a për një shumë prej €120,000. Clark sh.a-së aplikon një marzhe mbi kosto prej 25%. Prej këtyre mallrave €80,000 (sipas cmimit të blerjes) janë ende në stoke të Clinton sh.a.
- (v) Nuk ka pasur emetim shtesë të aksioneve në asnjërin prej kompanive.
- (vi) Me 31 dhjetor 2020 zëri i mirë në Clark sh.a është dëmtuar për €30,000 dhe investimi në Solana sh.a është dëmtuar për €40,000. Nuk ka pasur ndonjë dëmtim tjetër në periudhat e mëparshme.
- (vii) Është politikë e grupit të vlerësoj interesat jo-kontrollues sipas vlerës së plotë (të drejtë). Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues në Clark sh.a me 1 janar 2019 ishte €100,000.

Kërkohet:

Përgatite pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare të Clinton sh.a me 31 dhjetor 2020.

(20 pikë)

Zgjidhja e problemit 1

Grupi Clinton sh.a

	€'000
Pasuritë	
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>	
Prona, fabrika dhe paisjet (1,100+1,000+100-50L1)	2,150.00
Investimet në shoqëri L13	75.00
Investimet (180-100+60)	140.00
Zëri i mirë L1	<u>67.00</u>
	2,432.00
Pasuritë qarkulluese (500+220-16 FPR)	<u>704.00</u>
Total pasuritë	3,136.00
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>	
<i>Ekuiteti:</i>	
Aksionet e zakonshme prej €1 secila	400.00
Premia e aksioneve	300.00
Fitimet e mbajtura L14	61.60
Interesat jo-kontrollues L15	<u>61.40</u>
Total ekuiteti	823.00
<i>Detyrimet:</i>	
Detyrimet afatgjata (300+900+463L12)	1,663.00
Detyrimet afatshkurtëra (280+370)	<u>650.00</u>
Total detyrimet	<u>2,313.00</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	3,136.00

L11 Zëri i mirë	€'000
Clark sh.a	
Kosto e investimit 500×0.794	397.00
Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues	100.00
Vlera e drejtë e pasurive neto të blera:	
Aksionet e zakonshme (100.00)	
Premia e aksioneve (100.00)	
Fitimet e mbajtura (100.00)	
Korigjimi i vlerës së drejtë - fabrika (<u>100.00</u>)	
Vlera e drejtë e pasurive neto të blera	<u>(400.00)</u>
Zëri i mirë	97.00
Minus: Dëmtimi	<u>(30.00)</u>
	67.00

Zhvlerësimi shtesë në korigjimin e vlerës së drejtë ($100 \times 2/4$ vite) = 50

FPR = $80 - (80/1.25) = 16$

L12 Konsiderata e shtyrë	€'000
Vlera e tanishme me 1 janar 2019 L11	397.00
Interesi për shkak të ç'skontimit (viti1)@8%	31.76
Interesi për shkak të ç'skontimit (viti2)@8% ($397.00+31.76$) x 8%	<u>34.24</u>
Vlera me 31 dhjetor 2020	463.00

L13 Investimet në shoqëri	€'000
Kosto e investimit	100
Pjesa e fitimeve të mbajtura pas blerjes L14 50*30%	15
Dëmtimi i investimit	<u>(40)</u>
	75

L1 4 Fitimet e mbajtura

	Clinton sh.a	Clark sh.a	Solana sh.a
	€'000	€'000	€'000
Sipas pyetjes	500	(190)	100
Para blerjes		<u>100</u>	<u>50</u>
Pas blerjes		(290)	50
Zhvlerësimi shtesë		(50)	
Dëmtimi i zërit të mirë		(30)	
Dëmtimi i investimit në shoqëri	(40)		
Fitimi i porealizuar		<u>(16)</u>	
Interesi në konsideraten e shtyrë	(66)	(386)	
Pjesa e fitimit të shoqerise(50 x 30%)	15		
Pjesa e fitimit të deges (-386 x 90%)	<u>(347.4)</u>		
	61.6		

L1 5 Interesi jo-kontrollues	€'000
IJK ne fillim	100
Fitimet pas blerjes	<u>(38.6)</u>
IJK në fund	61.4

2. Bilanci vertetues në vijim është i Engel sh.a-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020.

	€'000	€'000
	Debi	Kredi
Shitjet		200,000
Blerjet	120,000	
Shpenzimet e shpërndarjes	10,000	
Shpenzimet administrative (shënimi ii)	30,000	
Liçenca (shënimi iii)	15,000	
Stoqet me 31 dhjetor 2019	28,000	
Shpenzimet e interesit	5,000	
Tatimi në fitim (shënimi iv)		1,000
Tatimi i shtyrë (shënimi iv)		5,000
Dividenda e paguar	5,000	
Prona, fabrika dhe paisjet – sipas kosto (shënimi v)	80,000	
Zhvlerësimi i akumuluar (31 dhjetor 2019)		14,850
Të arkëtueshmet tregtare	50,000	
Paraja	30,000	
Të pagueshmet tregtare		5,150
Provizionet për raste ligjore (shënimi ii)		20,000
Kredi afatgjatë		50,000
Kapitali aksionar		50,000
Fitimet e mbajtura me 31 dhjetor 2019		<u>27,000</u>
	373,000	373,000

Informata shtesë:

- i) Vlera bartëse e stoqeve me 31 dhjetor 2020 ishte €25 milion.
- ii) Shpenzimet administrative përfshijnë një provizion prej €20 milion për kostot e mundshme të një kërkesë ligjore të paraqitur kundër Engel sh.a nga një prej klientëve të tij para 31 dhjetorit 2020. Drejtorët e Engel sh.a-së konsiderojnë se ka më shumë gjasa që Engel sh .a-së mund të mbrojë me sukses çështjen, por ata kanë regjistruar këtë shumë si provizion për të qenë të kujdesëshëm nëse rezultati më i keq i mundshëm do të ndodh.
- iii) Me 1 janar 2020, Engel sh.a pagoi €15 milion për një liçencë dhjetëvjeçare për të drejtën e prodhimit dhe shitjes së një produkti. Liçenca amortizohet në baza drejtvizore. Nuk është regjistruar ende asnjë shumë për amortizimin. Shpenzimet e amortizimit të liçensës i ngarkohen koston së shitjeve.
- iv) Tatimi në fitim për vitin deri më 31 dhjetor 2020 është €2.8 milion. Gjatë vitit 2020, €2.2 milion u paguan në total për tatimin në fitim për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2019 dhe dhe u pagua tërësisht detyrimi i tatimit në fitim për vitin 2019. Pasqyra e pozitës financiare më 31 dhjetor 2019 kishte përfshirë €3.2 milion provizion në lidhje me këtë detyrim tatimor të tatimit në fitim.

Kërkohet një transferim prej €1.5 milion për të rritur detyrimin tatimor të shtyrë në pasqyrën e pozitës financiar; €500,000 nga kjo shumë ishte e nevojshme për shkak të diferencës së përkohshme të tatueshme të shkaktuar nga rivlerësimi i ndërtesës (shih shënimin v më poshtë).

v) Detajet e pronës, fabrikës dhe paisjeve janë si në vijim:

	Toka	Ndërtesa	Fabrika dhe paisjet
	€'000	€'000	€'000
Kosto me 1 janar 2020	15,000	20,000	45,000
Zhvlerësimi i akumuluar me 1 janar 2020	<u>-</u>	<u>3,600</u>	<u>11,250</u>
Vlera bartëse me 1 janar 2020	15,000	16,400	33,750

Prona, fabrika dhe paisjet zhvleresohen në baza drejtvizore pergjatë jetës së përdorimit e cila në datën e blerjes ishte si në vijim:

	Toka	Ndërtesa	Fabrika dhe paisjet
Jeta e përdorimit	Pa kufi	50 vite	4 vite

Zhvlerësimi i ndërtesës i alokohet shpenzimeve administrative përderisa zhvlerësimi i fabrikës dhe paisjeve i ngarkohet kostos së shitjes.

Me 1 janar 2020 drejtorët e Engel sh.a vendosen që të rivlerësojnë pronën (tokën dhe ndërtesën) në një vlerë të drejtë prej €35 milion duke përfshirë €16 milion për tokën. Nuk ka ndryshim në vlerësimin e jetës së përdorimit të pronës. Engel sh.a e transferon zhvlerësimin shtesë nga rivlerësimi në fitimet e mbajtura çdo vit.

Kërkohet:

a) Përgatite Pasqyrën e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Tjera Gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020. (8 pikë)

b) Përgatite Pasqyrën e Ndrysimeve në Ekuitet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020. (4 pikë)

c) Përgatite Pasqyrën e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2020. (8 pikë)

(total: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 2

Engel sh.a

Pasqyrën e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Tjera Gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

	€'000
Shitjet	200,000
Kosto e shitjes (L13)	<u>(135,750)</u>
Fitimi bruto	64,250
Shpenzimet e shpërndarjes	(10,000)
Shpenzimet administrative (L13)	<u>(10,463)</u>
Fitimi operativ	43,787
Shpenzimet e interesit	<u>(5,000)</u>
Fitimi para tatimit	38,787
Tatimi (L18)	<u>(2,800)</u>
Fitimi pas tatimit	35,987
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:	
Përfitimimi në rivlerësimin e pronës (3,600-500) (L15)	<u>3,100</u>
Total të radhurat gjithëpërfshirëse	39,087

Engel sh.a

Pasqyrën e Ndrysimeve në Ekuitet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

	Kapitali aksionar	Rezerva e rivlerësimit	Fitimet e mbajtura	Total
	€'000	€'000	€'000	€'000
Saldo me 1 janar 2020	50,000	-	27,000	77,000
Rivlerësimi i pronës (L15)		3,100		3,100
Fitimi i vitit			35,987	35,987
Transfer te FM (L16)		(63)	63	-
Dividenda e paguar			<u>(5,000)</u>	<u>(5,000)</u>
Saldo me 31 dhjetor 2020	50,000	3,037	58,050	111,087

Engel sh.a

Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2020

	€'000	€'000
Pasuritë		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet (16,000 +18,537 + 22,500)		57,037
Liçenca (15,000 - 1,500) (L11)		<u>13,500</u>
		70,537
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	25,000	
Të arkëtueshmet tregtare	50,000	
Paraja	<u>30,000</u>	
		<u>105,000</u>
		175,537

Ekuiteti dhe detyrimet

Ekuitet

Kapitali aksionar	50,000	
Rezerva e rivlerësimit	3,037	
Fitimet e mbajtura	<u>58,050</u>	111,087
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
Kredi afatgjatë	50,000	
Tatimi i shtyrë (L19)	<u>6,500</u>	56,500
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>		
Të pagueshmet tregtare	5,150	
Tatimi	<u>2,800</u>	<u>7,950</u>
		175,537

Llogaritjet:

1. Në përputhje me SNK 38 *Pasuritë e paprekshme*, €15 milionë të paguara për prodhimin dhe shitjes së një produkti duhet të kapitalizohen me kosto si një pasuri e paprekshme dhe të amortizohen gjatë jetës së dobishme ekonomike prej 10 vjetësh. Prandaj, duhet njihet një shpenzim i amortizimit €500,000 në vitin aktual.

2. Provizionet për kostot ligjore të €20 milion të kërkuara nga klienti është vetëm një detyrim aktual që rrjedh nga një ngjarje e kaluar nëse rasti shkon kundër Engel sh.a-së. Bazuar në skenarin në fjalë, është e pamundur që rasti të jetë humbje kështu që kriteret e njohjes të përcaktuara në SNK 37 *Provizionet, detyrimet kontingjente dhe pasuritë kontingjente* - nuk plotësohen. Andaj, €20 milion duhet të stornohen.

3. Alokimi i shpenzimeve operative

	Kosto e shitjeve	Shpenzimet e shpërndarjes	Shpenzimet administrative
	€'000	€'000	€'000
Stoqet në fillim	28,000		
Shpenz. sipas bilancit vertetues	120,000	10,000	30,000
Stoqet në fund	(25,000)		
Provizionet ligjore (L12)			(20,000)
Zhvlerësimi/ Amortizimi:			
- Ndërtesat (L14)			463
- Paisja(L14)	11,250		
- Pasuria e paprekshme (L11)	1,500	-	-
Total në pasqyrën e të ardhurave	135,750	10,000	10,463

4. Zhvlerësimi i pasurive jo-qarkulluese

Ndërtesa ka zhvlerësim të akumuluar prej €3,600, kështu që ishte nëntë vjet e vjetër kur u rivlerësua (€3,600/€400 = 9 vite). Jeta e dobishme ekonomike e mbetur në datën e rivlerësimit vlerësohet në $50-9 = 41$ vjet. Zhvlerësimi pas rivlerësimit ngarkohet me shumën e rivlerësuar.

	€'000
Ndërtesat - $(1/41 \times (19,000))$	463
Paisja - $(1/4 \times 45,000)$	<u>11,250</u>
Total zhvlerësimi për periudhën	11,713

5. Përfitimi në rivlerësimin e prones

	€'000
Shuma e rivlerësuar	35,000
Vlera bartëse para rivlerësimit $(35,000 - 3,600)$	<u>(31,400)</u>
Përfitimi në rivlerësim (para tatimit)	3,600
Tatimi i shtyrë	<u>(500)</u>
Rezerva e rivlerësimit e përfshirë në ekuitet	3,100

6. Transferi tek fitimet e mbajtura

	€'000
Zhvlerësimi në shumën e rivlerësuar	463
Zhvlerësimi në koston fillestare $(1/50 \times 20,000)$	<u>(400)</u>
	63

7. Prona, fabrika dhe paisjet

	Toka €'000	Ndërtesa €'000	Fabrika dhe paisjet €'000
Kosto me 1 janar 2020	15,000	20,000	45,000
Zhvlerësimi i akumuluar me 1 janar 2020	<u>-</u>	<u>3,600</u>	<u>11,250</u>
Vlera bartëse me 1 janar 2020	15,000	16,400	33,750
Përfitimi në rivlerësim	<u>1,000</u>	<u>2,600</u>	<u>-</u>
Rivlerësimi me 1 janar 2020	16,000	19,000	33,750
Zhvlerësimi në PA	<u>-</u>	<u>463</u>	<u>11,250</u>
Vlera bartëse me 31 dhjetor 2020	16,000	18,537	22,500

8. Shpenzimet e tatimit në fitim

	€'000
Tatimi në fitim për vitin 2020	2,800
Mbiprovizionimi për vitin e kaluar	(1,000)
Tatimi i shtyrë F/H $(1,500 - 500)$	<u>1,000</u>
Ngarkesa për vitin	2,800

9. Tatimi i shtyrë

	€'000
Sipas bilancit vertetues	5,000
Transferi i periudhës	<u>1,500</u>
Në fund	6,500

3.

a) Më 1 dhjetor 2019, Reynolds sh.a lidhi një kontratë shërbimi me klientët e saj për të shitur një paisje të telefonit mobil dhe një shërbim një vjeçar të rrjetit me një çmim prej €200.

Nëse klientët do ta blenin vetëm telefonin mobil, ai do të shitej me një çmim prej €100 dhe nëse shërbimi i rrjetit ofrohet veçmas për një vit, klienti do të detyrohet të paguajë shumën prej €200 për kohëzgjatjen njëvjeçare.

Kërkohet:

Llogaritni të hyrat nga kjo kontratë për vitet e përfunduara me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2020 në përputhje me kërkesat e SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me klientët.*

(10 pikë)

b) Me 1 janar 2020, Walker sh.a hyn në kontratë me një klient për të shitur një pasuri të prekshme për €2m. Kontrata përmban një opcion të shitjes për klientin i cili e obligon entitetin të riblejë pasurinë me kërkesë të klientit për €1.5m në apo para 31 dhjetor 2020, kohë në të cilën vlera e tregut pritët të jetë €1m.

Kërkohet:

Shpjegoni sesi transaksioni i mësipërm do të raportohet në pasqyrat financiare të Walker sh.a për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2020.

(4 pikë)

c) Korniza e BSNK -së (IASB-së) për përgatitjen dhe prezantimin e pasqyrave financiare kërkon që pasqyrat financiare të përgatiten mbi bazën që ato të jenë në pajtueshmëri me koncepte të caktuara kontabël dhe supozimin themelor.

Kërkohet:

Shpjegoni kuptimin e secilit prej koncepteve të mëposhtëm dhe supozimin themelor.

i) Përmbajtja mbi formën; dhe

ii) Supozimi i vazhdimësisë

(6 pikë)

(total 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 3

3.

a)

Obligimet e performancës

Çmimi i veçantë	€	%	Kontrata e kombinuar	€
Telefoni Mobil	100	33.33%	(33.33% x 200)	66.67
Sherbimi i rrjetit	<u>200</u>	<u>66.67%</u>	(66.67% x 200)	<u>133.33</u>
	300	100%		200.00

Të hyrat për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019	€
Të hyrat nga telefoni mobil	66.67
Të hyrat nga shërbimet e rrjetit (1/2 x 133.33)	<u>11.11</u>
Total të hyrat për vitin 2019	<u>77.78</u>

Të hyrat për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020	€
Të hyrat nga shërbimet e rrjetit (11/12 x 133.33)	122.22

b)

Në këtë rast klienti ka incentivë të madhe ekonomike ta ushtroj opcionin e shitjes sepse çmimi i riblerjes tejkalon vlerën e tregut në datën e riblerjes. Kjo nënkupton se kontrolli nuk ka kaluar tek klienti. Pasiqë klienti do ta ushtroj opcionin e shitjes, kjo e kufizon aftësinë e tij për të përdorur apo marrë përfitimet nga pasuria.

Në këtë situatë entiteti e trajton transaksionin si një lizing sipas SNRF 16 *Lizingjet*. Pasuria është dhënë me lizing tek klienti për periudhën deri në riblerje dhe diferenca prej €0.5m do të kontabilizohet si pagesa të pranuar në një lizing.

c)

(i) Substanca mbi formën

- Kjo do të thotë që regjistrimi i substancës së transaksionit (dhe ngjarjeve të tjera) kërkon që ato të trajtohen në përputhje me realitetin ekonomik ose qëllimin e tyre tregtar e jo thjeshtë formen ligjore.
- Ky është një element i rëndësishëm i prezantimit besnik.
- Një shembull i mirë i përmbajtjes mbi formën është një "transaksion" i qirasë ku qiramarrësit i lejohet të njohë pasurinë në pasqyrën e tij financiare.

(ii) Supozimi i vazhdimësisë

- është një koncept që supozon që një biznes vazhdon veprimtarinë për një të ardhme të parashikueshme. Supozohet se entiteti nuk ka as qëllim e as nevojë për t'u likuiduar apo të zvogëlojë në masë të madhe nivelin e veprimtarisë së tij. Kjo do të thotë, një entitet pritet të vazhdojë deri në përjetësi.

4.

a) Ngjarjet e mëposhtme u zhvilluan në Dole sh.a:

- (i) Menjëherë pas përfundimit të vitit financiar më 31 dhjetor 2020, por para se të autorizoheshin pasqyrat financiare për publikim, stoqet e Dole sh.a-së u shkatërruan nga një shpërthim zjarri i cili rezultoi në një humbje prej €2 milion.
- (ii) Viti financiar i kompanisë që përfundoi më 31 dhjetor 2020 tregon një shumë prej €6 milion që i takon një prej debitorëve të saj, kompania X. Dole sh.a parashikoi dëmtim me 31 dhjetor 2020 prej €1.5 milion kundrejt vlerës bruto prej €6 milion të të arketueshmeve nga kompania X. Me 31 janar 2021 para se të autorizoheshin pasqyrat financiare për publikim, kompania X u shpall e falimentuar dhe e paaftë për të paguar borxhin.
- (iii) Dole sh.a u padit më 31 dhjetor 2020, por gjykimi u dha vetëm më 21 janar 2021. Kompania u gjet përgjegjëse për dëmet dhe kostoja që arrinte në €3.1 milion ishin dhënë kundër saj. Më 22 janar 2021, Dole sh.a paraqiti një kërkesë tek siguruesit e saj dhe më 29 janar 2021, u njoftua se siguruesi do të mbulonte vetëm €2.6 milion të humbjes.

Kërkohet:

Këshillon menaxhmentin e Dole sh.a-së mbi trajtimin kontabël dhe/ose shpalosjet e kërkuara si rezultat i ngjarjeve në (i) deri (iii) pas datës së raportimit. (12 pikë)

b) Jackson sh.a. bleu në një pronë më 1 janar 2019 me një kosto prej €132 milion e cila kishte jetë ekonomike të përdorimit të vlerësuar prej 12 viteve dhe është vlerësuar se nuk kishte vlerë të mbetur në fund të jetës ekonomike të përdorimit. Politika e kompanisë është që të rivlerësojë pronat e saj në vlerën e tyre të drejtë në fund të çdo viti.

Zhvlerësimi i akumuluar eliminohet dhe prona rivlerësohet në shumën e rivlerësuar. Zhvlerësimi vjetor llogaritet mbi vlerat kontabël në fillim të vitit. Vlera e drejtë e pronës së më 31 dhjetor 2019 dhe 2020 ishte €127.05 milion dhe €96.25 milion respektivisht. Bilanci ekzistues i rezerves së rivlerësimit më 1 janar 2019 ishte €27.5 milion. Kjo lidhet me disa toka të pazhvlerësueshme vlera e të cilave nuk kishte ndryshuar ndjeshëm që nga 1 janar 2019. Është politikë e Jackson sh.a-së të transferoj zhvlerësimin shtesë tek fitimet e mbajtura në fund të çdo viti.

Kërkohet:

Përgatiti ekstraktet e Pasqyrës së Fitimit ose Humbjes dhe Pasqyrës së Pozitës Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 dhe 2020 sa i përket pronës. (8 pikë)

(total 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 4

4

a)

i) Stoqet e shkatërruara nga shpërthimi i zjarrit

- Kjo ngjarje është një "ngjarje jo-korigjuese" pasi është tregues i një gjendjeje (zjarri) që lindi pas përfundimit të periudhës raportuese.

- Meqenëse kjo është një ngjarje jo-korigjuese, asnjë korigjim nuk do të bëhet në shumën e njohur në pasqyrën financiare të kompanisë tuaj për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

- Sidoqoftë, nëse humbja e €2 milion është aq e rëndësishme sa mos shpalosja e saj do të ndikonte në vendimin ekonomik të përdoruesve të pasqyrave financiare, shpalosjen e natyrës së ngjarjes, vlerësimin e efekteve të saj financiare ose një deklaratë nëse një vlerësim i tillë nuk mund të bëhet do të kërkohej.

(ii) Falimentimi i kompanisë X

Kjo është një ngjarje jo-korigjuese dhe Dole sh.a duhet të ndaj provision për dëmtim tërë shumën e arkëtueshme (€6 milion) nga kompania X me 31 dhjetor 2020.

Falimentimi i saj pas përfundimit të periudhës raportuese siguron dëshmi të faktit se shuma e arkëtueshme nga kompania X ishte dëmtuar në fund të periudhës raportuese.

(iii) Detyrimi si rezultat i padisë

- Kjo është një "Ngjarje korigjuese" - Kjo ndodh sepse detyrimi ekzistonte në datën e raportimit, por konfirmimi i shumës u mor vetëm në 21 janar 2021.
- Pasqyra financiare duhet të korigjohen për të pasqyruar informacionin e marrë më vonë. Prandaj, provizioni duhet të bëhen për të gjithë shumën e kërkuar sipas vendimit të gjykatës.
- Paraqitja e kërkesës për sigurim u bë vetëm pas datës së raportimit; kështu që nuk duhet të merret parasysh kjo me 31 dhjetor 2020. Përderisa konfirmimi i suksesit të kërkesës u mor para datës së publikimit, kjo duhet të shpaloset në shënimet e pasqyrave financiare të Dole sh.a.

b)	Jackson sh.a	
	Ekstrakti i Pasqyrës së Fitimit ose Humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor	
	2019	2020
	€'000	€'000
Zhvlerësimi	(11,000)	(11,550)
Humbja nga rivlerësimi	-	(13,750)

Ekstrakt i Pasqyrës së pozitës Financiare me 31 dhjetor

	2019	2020
	€'000	€'000
Prona (II1)	127,050	96,250
Rezerva e rivlerësimit:		
Saldo 1 janar 2019	27,500	
Përfitimi nga rivlerësimi (II1)	<u>6,050</u>	
	33,550	
Transfer tek fitimet e mbajtura (6,050 x 1/11)	(550)	
Pjesa e humbjes nga rivlerësimi	<u>(5,500)</u>	
	27,500	
Llogaritjet: L1	€'000	
Kosto 1 janar 2019	132,000	
Zhvlerësimi (132,000 /12)	<u>(11,000)</u>	
31 dhjetor 2019	121,000	
Përfitimi nga rivlerësimi	<u>6,050</u>	
Vlera bartëse me 31 dhjetor 2019	127,050	
Zhvlerësimi deri me 31 dhjetor 2020 127,050/11 vite	<u>(11,550)</u>	
	115,500	
humbja nga rivlerësimi që i ngarkohet rezervës së rivlerësimit	(5,500)	
humbjes nga rivlerësimi që i ngarkohet fitimit ose humbjes	<u>(13,750)</u>	
Vlera bartëse me 31 dhjetor 2020	96,250	

5. Më poshtë janë paraqitur ekstraktet e pasqyrave financiare të Albright sh.a-së. Albright sh.a nuk paguan tatim në fitim.

Ekstrakt nga Pasqyra e Fitimit ose Humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor

	2020	2019
	€'000	€'000
Shitjet	224,000	195,000
Kosto e shitjeve	<u>(169,200)</u>	<u>(136,500)</u>
Fitimi bruto	54,800	58,500
Shpenzimet administrative	(32,700)	(38,040)
Shpenzimet e shpërndarjes	(10,900)	(12,680)
Shpenzimet e interesit	<u>(1,900)</u>	<u>(1,380)</u>
Fitimi neto	9,300	6,400

Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 dhjetor

	2020		2019	
Pasuritë	€'000	€'000	€'000	€'000
Pasuritë jo-qarkulluese		37,000		28,600
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>				
Stoqet	12,800		9,800	
Të arkëtueshmet tregtare	24,600		21,600	
Paraja	<u>1,600</u>		<u>2,400</u>	
		<u>39,000</u>		<u>33,800</u>
Total pasuritë		76,000		62,400

Ekuiteti dhe detyrimet

Kapitali aksionar i zakonshëm	16,000		16,000	
Fitimet e mbajtura	<u>26,200</u>		<u>18,600</u>	
		42,200		34,600
<i>Detyrimet afatgjata:</i>				
10% Kredi		16,000		12,000
<i>Detyrimet afatshkurtëra:</i>				
Mbitërheqja bankare	2,800		2,000	
Të pagueshmet tregtare	<u>15,000</u>		<u>13,800</u>	
		<u>17,800</u>		<u>15,800</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet		76,000		62,400

Në vijim janë koeficientët e llogaritur për Albright sh.a për vitin 2019 dhe mesataret e industrisë për vitin 2020:

	Albright sh.a	Mesatarja e industrisë
Marzha e fitimit neto	3.28%	4.00%
KNKA(Kapitali i angazhuar = (ekuiteti + kredia)	16.69%	18.50%
Qarkullimi i pasurive	4.19 here	3.91 here
Koeficienti i qarkullimit	2.14:1	1.90:1
Koeficienti i shpejtë	1.52:1	1.27:1
Marzha e fitimit bruto	30.0%	35.23%
Periodha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme	40 ditë	52 ditë
Periodha e pagesës së llogarive të pagueshme	37 ditë	49 ditë
Qarkullimi i stoqeve (here)	13.9 here	18.3 here
Koeficienti i hyrjes në borxh/leverazhi	25.75%	32.71%

Kërkohet:

- a) Llogarite ciklin operativ të parasë të Albright sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, dhe 2020. (5 pikë)
 - b) Llogariti koeficientët krahasues për Albright sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020. (5 pikë)
 - c) Drafto një raport për Bordin e Drejtorëve që tregon analizën dhe performancën financiare të Albright sh.a, për vitin 2020 duke e krahasuar me rezultatet e vitit të kaluar dhe mesataren e industrisë. (10 pikë)
- (total 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 5

(a) Albright sh.a

Cikli operativ i parasë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 dhe 2020

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Periudha e qarkullimi të stoqeve	28 ditë	26 ditë
Periudha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme	40 ditë	40 ditë
Periudha e pagesës së llogarive të pagueshme	<u>(32 ditë)</u>	<u>(37 ditë)</u>
Cikli operativ i parasë (në ditë)	36 ditë	29 ditë

Llogaritjet:

Periudha e qarkullimi të stoqeve = $\text{Stoqet} / \text{Kosto e shitjes} \times 365 \text{ ditë}$

2020: $12,800 / 169,200 \times 365 \text{ ditë} = 28 \text{ ditë}$

2019: $9,800 / 136,500 \times 365 \text{ ditë} = 26 \text{ ditë}$

Periudha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme = $\text{Të arkëtueshmet tregtare} / \text{Shitjet} \times 365 \text{ ditë}$

2020: $24,600 / 224,000 \times 365 \text{ ditë} = 40 \text{ ditë}$

2019: $21,600 / 195,000 \times 365 \text{ ditë} = 40 \text{ ditë}$

Periudha e pagesës së llogarive të pagueshme = $\text{Të pagueshmet tregtare} \times 365 \text{ ditë}$

2020: $15,000 / 169,200 \times 365 \text{ ditë} = 32 \text{ ditë}$

2019: $13,800 / 136,500 \times 365 \text{ ditë} = 37 \text{ ditë}$

(b) Albright sh.a

Llogaritja e koeficientëve për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

Marzha e fitimit neto = $\text{Fitimi neto} / \text{Shitjet} \times 100 = (9,300+1,900) / 224,000 \times 100 = 4.15\%$

Kthimi në kapitalin e angazhuar (KNKA) =

= $\text{FPIT} / \text{Kapitali i angazhuar} = \text{ekuiteti} + \text{kredia} \times 100$

= $(9,300+1,900) / (42,200+16,000) \times 100 = 19.24\%$

Qarkullimi i pasurive = $\text{Shitjet} / \text{Kapitalin i angazhuar} = 224,000 / 58,200 = 3.85 \text{ here}$

Koeficienti i qarkullimit = $\text{Pasuritë qarkulluese} / \text{Detyrimet afatshkurtëra} =$

= $39,000 / 17,800 = 2.19:1$

Koeficienti i shpejtë = $(\text{Pasuritë qarkulluese} - \text{Stoqet}) / \text{Detyrimet afatshkurtëra} =$

= $(39,000 - 12,800) / 17,800 = 1.47:1$

Marzha e fitimit bruto = $\text{Fitimi bruto} / \text{Shitjet} \times 100 = 54,800 / 224,000 \times 100 = 24.46\%$

Periudha e grumbullimit të llogarive të arkëtueshme (shih në a) = 40 ditë

Periudha e pagesës së llogarive të pagueshme (shih në a) = 32 ditë

Qarkullimi i stoqeve (here) = $\text{Kosto e shitjes} / \text{Stoqet} = 169,200 / 12,800 = 13.2 \text{ here}$

Koeficienti i hyrjes në borxh/leverazhi =

$\text{borxhi me interes} / \text{Ekuiteti i aksionarëve} + \text{borxhi me interes} \times 100 =$

= $16,000 / (42,200+16,000) \times 100 = 27.49\%$

(c)

Për: Bordin e drejtorëve

Nga: Kontabilisti

Tema: Analiza e performancës së Albright sh.a

Profitabiliteti

Kthimi i kapitalit të angazhuar është përmirësuar ndjeshëm midis 2019 dhe 2020 dhe tani është më lartë se mesatarja e industrisë.

Fitimi neto si përqindje e shitjeve është përmirësuar dukshëm këtë vit dhe gjithashtu tani është paksa më lartë mesatares së industrisë. Marzha bruto, megjithatë, është dukshëm më e ulët se një vit më parë dhe është vetëm rreth 70% e mesatares së industrisë. Kjo sugjeron, ose se ka pasur një ndryshim në strukturën e kostos së Albright sh.a ose se ka pasur një ndryshim në metodën e shpërndarjes së kostos midis periudhave. Sido që të jetë, ky është një ndryshim i dukshëm që kërkon hetim. Albright sh.a mund të jetë në një periudhë tranzicioni pasi shitjet janë rritur me gati 15% gjatë vitit dhe duket se janë blerë pasuri të reja jo-qarkulluese.

Qarkullimi i pasurive ka rënë midis periudhave edhe pse shifra e vitit 2020 është në përputhje me mesataren e industrisë. Kjo ulje mund të tregojë se efikasiteti me të cilin përdoren pasuritë është përkeqësuar ose mund të tregojë se pasuritë e blera në vitin 2020 nuk kanë kontribuar ende plotësisht në biznes. Një prirje afatgjatë do të sqaronte këtë.

Likuiditeti dhe menaxhimi i kapitalit qarkullues

Koeficienti i qarkullimit është përmirësuar pak gjatë vitit dhe është paksa më i lartë se mesatarja e industrisë. Është gjithashtu në përputhje me atë që përgjithësisht konsiderohet si e kënaqshme (2:1).

Koeficienti i shpejtë ka rënë pak, por është akoma më i lartë se mesatarja e industrisë. Kjo sugjeron që Albright sh.a nuk ka probleme likuiditeti afatshkurtër dhe nuk duhet të ketë vështirësi në pagimin e borxheve të tyre në kohën e pagesës.

Të arkëtueshmet si përqindje e shitjeve janë të pandryshuara nga viti 2019 dhe janë dukshëm më të ulëta se mesatarja e industrisë. Rrjedhimisht, ka ndoshta pak mundësi për ta zvogëluar këtë më tej dhe mund të ketë presion në të ardhmen nga klientët për të rritur periudhën e afatit të pagesës. Periudha e pagesës ndaj furnitorëve ka rënë nga 37 ditë në 32 ditë dhe është shumë më e ulët se mesatarja e industrisë; kështu, mund të jetë e mundur të financoni çdo blerje shtesë duke negociuar kushte më të mira të pagesës nga furnitorët.

Qarkullimi i stokeve ka rënë pak dhe është shumë më i ngadalshëm se mesatarja e industrisë, kjo mund të reflektojë pjesërisht akumulimin para një rritjeje të konsiderueshme të shitjeve. Përndryshe, ekziston një rrezik që stoqet të përmbajnë disa artikuj të vjetëruar që mund të kërkojnë fshirje. Rritja relative e nivelit të stokeve është financuar nga rritja e mbitërheqjes e cila mund të zvogëlohet nëse nivelet e stokeve mund të ulen.

Hyrja në borxh/Leverazhi

Niveli i leverazhit është rritur vetëm pak gjatë vitit dhe është nën mesataren e industrisë. Meqenëse kthimi i kapitalit të angazhuar është gati dyfishi i normës së interesit në kredi, dhe përfitimi ka të ngjarë të rritet me një rritje modeste të nivelit të leverazhit.